

Chandigarh

AHMAD ADIL

Edhe pse kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May ka shprehur "keqardhje" për masakrën e vitit 1919 nga trupat britanike në Indi, shumë nga vendet e Azisë Jugore presin një kërkim faljeje zyrtare nga autoritetet britanike.

"Në mesin e njerëzve vërehet një ndjenjë se autoritetet britanike duhet të kërkojnë falje për masakrën", tha për Anadolu Agency (AA), Prof. Sukhmani Bal Rair, ekspert i historisë moderne në Universitetin Panjab të Chandigarh.

Më 13 prill 1919, kur shënohet edhe Dita e Baisakit - Festivali i pranverës që shënon Vitin e Ri në Sikhizëm, trupat britanike të udhëhequr nga koloneli Reginald Dyer hapën zjarr ndaj civilëve, të cilët ishin mbledhur në Jallianwala Bagh në qytetin Amritsar.

Sipas një raporti të Komisionit të Gjuetarëve të themeluar nga qeveria britanike, trupat e Dyer-it gjuajtën 1.650 herë mbi protestuesit e paarmatosur, përfshirë gratë dhe fëmijët. Sipas raportit, numri i të vdekurve ishte 379, por thuhet se numri i të vdekurve ishte shumë më i lartë se kaq, ndërkaq mbi 1.000 të tjerë mbetën të plagosur nga të shtënat.

Edhe pse kanë kaluar 100 vjet, masakra ende ngjall zemërimin dhe pikëllimin në mendjen e njerëzve.

"Kjo është ngjarja më e keqe në historinë e Indisë. Qeveria britanike duhet të kërkojë falje përpara publikut të Indisë. Kam lexuar në libra se si u martirizuan të pafajshmit atë ditë", tha Varun Bhatia, një student në shtetin Punjab të Indisë.

Duke shprehur keqardhjen për incidentin, May tha të enjten: "Tragjedia e Jallianwala Bagh në vitin 1919 është një mbresë e turpshme në historinë britaniko-indiane. Siç ka thënë edhe lartmadhëria e saj, Mbretëresha para se të vizitonte Jallianwala Bagh në vitin 1997, ky është një shembull shqetësues i historisë sonë të kaluar me Indinë. Ndjejmë shumë keqardhje për atë që ka ndodhur dhe vuajtjet e shkaktuara. Jam e kënaqur që sot marrëdhëniet e Mbretërisë së Bashkuar me Indinë janë të një bashkëpunimi, partneriteti, prosperiteti dhe të sigurisë".

Në vitin 2013, kryeministri britanik David Cameron po ashtu kishte vizituar shtetin Punjab dhe e përshkroi incidentin si një "ngjarje shumë të turpshme në historinë britanike".

Njerëzit duan më shumë

Dalbari Lal, ish-ministër në shtetin e Punjabit, për AA tha se të gjithë në Indi duan kërkim faljeje zyrtare nga autoritetet britanike, por ai tha se gjasat janë të vogla për një gjë të tillë.

"Ata duhet të kërkojnë falje për masakrën. Por, kjo nuk do të ndodhë kurrë, sepse nëse e bëjnë këtë, dikush nga India do t'i drejtohet gjykatave dhe do të kërkojë kompensim. Gjithashtu ka disa njerëz që justifikojnë veprimet e Dyer-it", tha Lal.

Në shkurt të vitit 2019, kuvendi shtetëror i Punjabit miratoi njëzëri një rezolutë, e cila kërkonte kërkim faljeje nga qeveria britanike për masakrën.

Gjithashtu edhe një ministër pakistanez ka kërkuar kërkim faljeje nga Mbretëria e Bashkuar për masakrën.

"Mbështesim plotësisht kërkesën që perandoria britanike duhet të kërkojë falje ndaj kombeve të Pakistanit, Indisë dhe Bangladeshit për masakrën në Jallianwala dhe Bengalit për mungesën e ushqimit, këto tragjedi janë njolla në fytyrën e Britanisë, gjithashtu diamanti Kohenoor duhet të kthehet në muzeun Lahore ku i takon", është shprehur përmes Twitter-it ministri i Informacionit të Pakistanit, Fawad Chaudhry të enjten.

Megjithatë, profesori Rair tha përveç faljes "ne gjithashtu duhet të kërkojmë për më shumë, pra të na japin të dhënat ashtu që ne të mund të përpilojmë historinë e asaj periudhe".

Mahesh Behal, i cili është në moshën 70-vjeçare dhe nip i njërit nga viktimat e masakrës në Jallilanwala Bagh, tha se qeveritë indiane "nuk kanë bërë shumë" për familjet e viktimave.

"Gjenerali Dyer është Kasapi Dyer për Indinë dhe për familjet si ne", tha Behal.

"Qeveria nuk ka bërë asgjë për familjet përveç dhënies së mirënjohjes të luftëtarit të lirisë, e cila mund të përdoret për t'u liruar nga taksat në autostradat", shtoi ai.

Behal tha se masakra ishte një "pikë e rëndësishme" për pavarësinë e Indisë nga sundimi britanik. "Të paktën qeveria duhet të tregojë respekt për viktimat, në mënyrë që të gjithë të pranojnë sakrificën e atyre që u martirizuan", shtoi ai.

Tek Chand, 73 vjeç, gjyshi i të cilit Khushi Ram u vra gjithashtu në Jallilanwala Bagh, për AA tha se autoritetet e atëhershme kishin njoftuar disa kompensime, por asnjëherë nuk na janë dhënë. Qeveria britanike ende nuk ka bërë asnjë kërkim faljeje, ata duhet të kërkojnë falje", tha Chand./AA/